



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1306 Prot.

Tiranë, më datë 06.10.2023

**VENDIM**  
**Nr. 537, datë 06.10.2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.10.2023:

**VENDOSI:**

1. Mosmiratimin e vijimit të procedurës së legalizimit me objekt “Objekt 1 kat”, i ndodhur Brenda kufirit të Zonës së Mbrojtur të pasurisë kulturore “Hamami i Pazarit”, Monument Kulture i Kategorisë I-rë, Elbasan, me subjekt aplikues **Znj. Elena Aleksandër Marku** për arsye se:
  - a) Objekti informal, cënon vëllimin/ pamjen e jashtme të monumentit të kulturës pasi pozicionohet brenda kufirit të zonës së mbrojtur të pasurisë kulturore “Hamami i Pazarit”, Monument kulture i kategorisë I-rë, Elbasan sipas VKM Nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” Kreu II, pika 15, gërma dh);
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Klesta QIRICI

KRYETAR  
Eva MARGARITI

